

LIGJ
Nr. 65/2023

PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 10 383, DATË 24.2.2011,
“PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Pas pikës 4 të nenit 7 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Personat e punësuar me profesion në fushën e teknologjisë së informacionit (IT) dhe të regjistruar në subjektet me aktivitet kryesor në fushën e teknologjisë së informacionit, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas ligjit nr. 58/2022, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi për këtë kategori, paguajnë kontributet e sigurimeve shëndetësore në nivelin e pagës minimale mujore në shkallë vendi, me miratimin paraprak të punëmarrësit, të evidentuar në kontratën e punës, pavarësisht pagës bruto të deklaruar.”.

Neni 2

Në pikën 1 të nenit 8 fjalët “sipas pikave 1, 3 dhe 4” zëvendësohen me fjalët “sipas pikave 1, 3, 4 dhe 5”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 21.7.2023.

Shpallur me dekretin nr.181, datë 31.7.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.